

Fjalimi në Kreuzlingen, me rastin e 30 vjetorit të xhamisë

Eudhu Bil-lahi, Bismil-lahi

- E nderuara kryesi, me në krye kryetarin e xhamisë, **Besir Halili**

- I nderuar dhe i respektuar imam i xhamisë, **Mr. Rejhan Neziri**

- **Sehr geehrter Herr Stadtpräsident, Niederberger**

- Shumë të respektuar mysafirë dhe drejtorë të bashkësive islame për diasporën Maqedonia e Veriut dhe Republika e Kosovës, përfaqësues të spektrit politik e diplomatik, hoxhallarë, profesorë, përfaqësues të organizatave fetare, përfaqësues të xhamive tona në Zvicër, si dhe ju vëllezër e motra!

Fillimisht dëshiroj t'ju përshëndes me selamin tonë ngrohtë: **“Esselamu alejkum ve rahmetullahi ve berekatuhu!** - Paqja dhe mëshira e Zotit qoftë mbi të gjithë ju!”

Sot jam këtu për t'ju përcjell selamet dhe urimet më të ngrohta të miat dhe të kryesisë së KMSHZ-së, si dhe të të gjithë qendrave tona, përfshirë imamët dhe kryesitë e tyre, me rastin tuaj të shënimit të 30 vjetorit të xhamisë “Hëna e Re” në Kreuzlingen.

Ju nuk e ndërtuat vetëm formalisht këtë xhami, por e ndërtuat edhe më bukur dhe e bëtë edhe më madhështore frymën e saj, kuptimin respektiv të saj. Ndonëse si ndërtesë nuk dallohet edhe shumë, por si emër e vepër, kjo qendër është shumë e madhe dhe shumë e rëndësishme për qytetin e Kreuzlingenit, kantonin e Thurgau-s dhe për mbarë Zvicrën. Prandaj, keni plotësisht të drejtë të jeni krenarë me këto vite dhe keni të drejtë të festoni me rastin e shënimit të këtij viti jubilar.

Të respektuar të pranishëm!

Është një fakt që nuk e mohojmë dot, tashmë në Zvicër xhamitë tona, po me këto organizime përvjetorësh, po tregojnë historinë e tyre; po tregojnë e dëshmojnë për sukseset dhe zhvillimet pozitive brenda xhematit, shoqërisë dhe vendit ku janë. Kjo më bënë të them se zhvillimi ynë institucional është në ngritje e sipër dhe mund të jemi krenarë për atë që xhamitë tona kanë arritur. Çfarë thotë e tërë kjo? Çfarë na thonë gjithë këto organizimeve përvjetorësh, tashmë, njëra pas tjetrës, duke shënuar 20 vjetorin apo 30 vjetorin, e dikush edhe 35 vjetorin? A nuk flet kjo vetvetiu se ne duam xhami, se duam Zot dhe se duam t'i ruajmë vlerat tona në rrugë institucionale?

Le të shikojmë Kur'anin dhe le të mësojmë funksionin që ka xhamia në Islam.

إِنَّمَا يَعْمُرُ مَسَاجِدَ اللَّهِ مَنْ آمَنَ بِاللَّهِ وَالْيَوْمِ الْآخِرِ وَأَقَامَ الصَّلَاةَ وَآتَى الزَّكَاةَ وَمِمَّا يَخْشَى اللَّهَ فَعَسَىٰ أُولَٰئِكَ أَنْ يَكُونُوا مِنَ الْمُهْتَدِينَ

“Shtëpitë e Allahut i vizitojnë dhe i mirëmbajnë vetëm ata që besojnë Allahun dhe Ditën e Fundit, që falin namazin dhe japin zekatin e që nuk i frikësohen askujt, përveç Allahut. Sigurisht që këta janë në rrugë të drejtë.” (Teube 18).

وَأَنَّ الْمَسَاجِدَ لِلَّهِ فَلَا تَدْعُوا مَعَ اللَّهِ أَحَدًا

“Xhamitë i janë kushtuar vetëm Allahut, prandaj mos iu lutni askujt krahas Allahut!” (Xhin, 18)

Nga sa kuptojmë, ajetet na e bëjnë të qartë se për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e një xhamie, nevojitet, së pari, besim dhe bindje e pastër. Po ashtu, nga ajetet kuptojmë se xhamitë kanë një rol të madh në edukimin e njerëzve, të cilët falin rregullisht namazet, japin zeqatin dhe nuk i frikësohen askujt tjetër pos All-llahut xh.sh., dhe kështu të vazhdojë, gjeneratë pas gjenerate. Xhamia ka kuptim vetëm nëse edukon, ose ndryshe thënë, ajo është qendra e jetës islame.

Të dashur miq e dashamirë, vëllezër e motra!

Pa dashur të zgjatem edhe më tepër, dëshiroj që në emër të KMSHZ-së t’ju falënderoj shumë për ftesën dhe t’ju uroj këtë ditë të madhe historike për ju dhe për të gjithë komunitetin muslimanë që jeton në këtë qytet dhe rrethinë.

Allahu u shpërbleftë për çdo kontribut tuajin. Paraja juaj, djersa juaj, mundi dhe koha juaj kushtuar xhamisë nuk kanë shkuar kot. Ja, pra, kjo që sot e keni, tregon se sa i madh është ky projekt për shqiptarët, muslimanët dhe të gjithë qytetarët e Kreuzlingenit.

Qofshin të bekuara vitet e kaluara, si dhe paçi një të ardhme më të ndritur, më të mirë dhe më të dëlirë!

Mëshira dhe rahmeti i Allahu xh.sh. qoftë mbi merhumët e këtij xhemati, të cilët, po të ishin gjallë, edhe ata do të ishin bashkë me ne. Ndërsa ne sot, ata i kujtojmë me dua e lutje!

Urime edhe njëherë 30 vjetori i Xhamisë!

Hfz. Mehas Alija

Kreuzlingen, 28.01.2023